



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2020:040742

Datë: 31.01.2024

Numri i dokumentit: 05268215

C. nr. 219/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil me gjyqtarin Astrit Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Xh.K nga Glllogoci të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj A.D, kundër të paditurës Komuna e Glllogocit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Glllogoc, me objekt kontesti kompensim i ushqimit-shujtës ditore, vlera e kontestit prej 5,339.76 €, pas seancës së shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 27.12.2023, në të cilën ishte i pranishëm i autorizuari i paditëses e në mungesë të përfaqësuesit të të paditurës, e mori ndërsa me datën 26.01.2024 e përpiloj, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses Xh.K nga Glllogoci, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Glllogocit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Glllogoc që paditëses të ia paguaj në emër të licencimit/kualifikimit për bachelor për periudhën nga data 17.04.2017 deri me datën 21.11.2022 shumën prej 4,097.00 Euro si dhe kamatën ligjore prej 8 % në vit për atë periudhë në shumën prej 1,242.76 Euro, gjithsejt shumën e përgjithshme prej 5,339.76 Euro, në afat prej shtatë (7) ditë nga pranimi i këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.
- II. OBLIGOHET** i padituri Komuna e Glllogocit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Glllogoc që paditëses Xh.K nga Glllogoci të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 1,334.00 €, në afat prej shtatë (7) ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësja përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar padi ndaj të paditurës fillimisht për kompensimin e shujtave ditore duke theksuar se nga marrëdhënia e punës e paditëses me institucionin arsimor derivon e drejta për pagesën e shujtës ditore në bazë të Nenit 35 par. 5 dhe 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Në seancën e shqyrtimit kryesor të rihapur pas ndërprerjes të mbajtur me datën 27.12.2023 fillimisht i autorizuari i paditëses e ka ndryshuar padinë në kuptimin objektiv dhe atë nga padia me kërkesën për kompensimin e shujtave ditore në padinë me kërkesën për kompensimin lidhur me kualifikim/gradim. Gjykata në bazë të aktvendimit në seancë ka aprovuar ndryshimin e padisë dhe ka vazhduar me procedurën kontestimore me kërkesëpadinë për kompensimin lidhur me Kualifikimin/licencimin.

I autorizuari i paditëses në seancën kryesore të datës 27.12.2023 ka deklaruar se: *pas ndryshimit të padisë dhe pranimit të ekspertizës ka precizuar lartësinë e kërkesë padisë në shumën prej 4,097.00 euro në emër të borxhit kryesor, ndërsa në emër të kamatës ligjore shumën prej 1242.76 Euro e në shumën e përgjithshme prej 5,339.76 Euro në përputhje me ekspertizën financiare, ndërsa në fjalën përfundimtarë të paraqitur me shkrim ka theksuar e drejta për kompensimin e kualifikimit arsimor/licencimit rrjedhë në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit, Vendimit të Qeverisë, Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme, tutje ka theksuar se në bazë të ekspertizës financiare të datës 15.12.2023 rezulton se e paditura duhet të bëjë kompensimin e borxhit dhe kamatës ligjore në emër të kualifikimit arsimor për paditësen në periudhën kohore prej datës 17.04.2017 deri me datën 21.11.2022, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses saj të e aprovoj në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.*

E paditura nuk ka dhënë përgjigje në padi sipas Aktvendimit të datës 17.06.2021, dhe nuk ka marr pjesë në seancat gjyqësore e ftuar në mënyrë të rregullt, duke paraqitur gjatë seancave parashtrës/deklarime, poashtu e paditura nuk ka marrë pjesë në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor me datë 27.12.2023 por me parashtrësën/deklarimin e të njëjtës datë 27.12.2023 e ka kundërshtuar edhe njëherë kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar se paditësja sa i përket kompensimit të shujtave i ka realizuar në procedurën administrative pranë organit të Inspektoratit të Punës, ndërsa sa i pjesës së kërkesëpadisë lidhur me kualifikimin arsimor për të njëjtën, Komuna e Gllogocit qëndron pranë deklarimeve të saja të bëra deri më tani duke vazhduar të kundërshtoj kërkesëpadinë e palës paditëse, dhe në bazë të ekspertizës së ekspertit A.B në ekspertizën e tij të datës 06.12.2021 me të cilën në mënyrë të qartë ka mohuar për një të drejtë të tillë për palën në fjalë, institucioni në këtë drejtim konsideron të nevojshme të potencoj edhe Mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës 214//2023 të datës 09.10.2023 ku theksohet se “*për kërkesat e mësimdhënësit për kompensimin mbi bazën e kualifikimit kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, po ashtu e kundërshtojnë ekspertizën financiare të ekspertes A.R të datës 15.12.2023 pasi që e njëjta është në kundërshtim me ekspertizën nga Lëmia e sigurimeve aktuaristikës dhe financave të A.B e datës 06.12.2021, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të pa bazuar.*

Gjendja faktike dhe Provat materiale:

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: *Vërtetimi i SHML “Gj K. Skënderbeu” me nr... i datës 30.01.2020, Kontrata vazhduese e marrëdhënies së punës e datës 26.09.2016 me nr..., Parashtrësja e të paditurit e datës 08.09.2021, Diploma në emër të paditëses e kualifikimit universitar me nr... e datës 10.04.2006, Vërtetimi nr... i datës 07.06.2022, Licenca e mësimdhënësit në emër të paditëses me nr... i datës 02.03.2015 dhe 02.03.2020, Parashtrësja e paditëses e datës 21.09.2021, Fletë pagesa bankare për ekspertin A.B shumën prej 150 Euro e datës 11.09.2021, Parashtrësja e të paditurit e datës 11.12.2021, Ekspertiza e ekspertit A.B e datës 13.09.2021, Plotësimi i ekspertizës së ekspertit A.B e datës 06.12.2021, Parashtrësja-deklarimi i të paditurit e datës 11.05.2022, Parashtrësja e ekspertit A.B e datës 23.05.2022, Vendimi i Qeverisë së R. Kosovës me nr... i datës 29.08.2008, Parashtrësja e paditësit e datës 31.05.2022, Parashtrësja e të paditurit datë 10.06.2022, Parashtrësja e paditësit datë 29.06.2022, Parashtrësja e të paditurit datë 31.10.2022 së bashku me një kopje të propozimit për përmbarrim të përmbarruesit H.H i datës 26.10.2022 me nr..., Vendimi i inspektoratit të punës me nr... i datës 14.10.2022, Urdhëri përmbarrimor me P.nr... i datës 26.10.2022, Aktvendimi për ndërprerjen e procedurës datë 09.12.2022, Parashtrësja e të paditurit datë 07.12.2023, Mendimi juridik i Gjykatës Supreme datë 09.10.2023, Lista e pagave në emër të paditëses-në datat 21.09.2017, 24.10.2018, 25.04.2019, 21.12.2020 dhe 24.12.2021, Aktvendimi për caktimin e ekspertes financiare A.R e datës 07.12.2022, Ekspertiza financiare e ekspertes A.R e datës 15.12.2023,*

Parashtrësa për precizim të padisë në aspektin objektiv e datës 19.12.2023 e cila i është dërguar të paditurës me datë 21.12.2023, dhe Procesverbalet e datës 26.02.2021, 08.09.2021, 19.11.2021, 12.05.2022, dhe 10.06.2022.

Gjykata pasi bëri vlerësimin e provave mbështetur në dispozitat e Nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), gjeti se kërkesëpadija e paditësve është e bazuar, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se paditësja ka qenë e punësuar tek e paditura, me pagë mujore neto prej 476.25 €, ky fakt vërtetohet në bazë të Kontrata vazhduese e Marrëdhënies së Punës me nr... e datës 26.09.2016 e lidhur në mes palëve ndërgjyqëse nga datës 10.10.2016 deri me datën 10.10.2020 pranë shkollës së Mesme të Lartë Gjinnazi GJ.K. Skënderbeu.

Nuk ishte kontestuese fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie të punës e sistemuar si mësimdhënëse në SHML “GJ.K Skënderbeu”. Ky fakt vërtetohet në bazë të Vërtetimit me nr... i datës 07.06.2021 nga SHML. GJ.K. Skënderbeu.

Nuk ishte kontestuese fakti se paditësja ka qenë e licencuar, ky fakt është vërtetuar në bazë të Licencës së Mësimdhënësit me nr... në emër te paditësës se e njëjta ka qenë e licencuar nga data 02.03.2015 deri me datën 02.03.2020.

Ekspertja A.R në bazë të ekspertizës së datës 14.12.2023 ka konstatuar duke llogaritur shumën e borxhit nga 60.25 Euro për çdo muaj për periudhën kohore nga data 17.04.2017 deri me datën 21.11.2022 në shumën e përgjithshme në emër të borxhit kryesor lartësinë prej 4,097.00 Euro, dhe në emër të kamatës ligjore prej 8 % në vit në shumën prej 1,242.76 Euro, gjithsejt shumën prej 5,339.76 Euro.

Faktet kontestuese:

Si kontestues në mes palëve ndërgjyqëse ishte fakti se a i takon kompensimi paditësës si në kërkesëpadi.

Paditësja pretendon se edhe për kundër faktit që i ka kryer obligimet gjegjësisht detyrat e punës për periudhën kohore të cekur në kontratë, andaj e paditura konform dispozitave ligjore ka obligim kompensimin.

E paditura e konteston kërkesëpadinë e paditësës me arsyetimin se mungon baza ligjore duke pasur parasysh Mendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës se për kërkesat e mësimdhënësve për kompensimin mbi bazën e kualifikimit bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Vendim të Qeverisë së Kosovës Nr. 01/33 datë 29.08.2008.

Baza juridike dhe vlerësimet e gjykatës

Gjykata vlerësoj se vendosja e kësaj çështje juridike kontestuese si në dispozitiv të aktgjykimit sa i përket aprovimit të padisë së paditësës për Kompensimin e Licencimit-kualifikimit gjen te Kontratat Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK) të miratuara dhe të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) me datën 18.04.2017 dhe me datë 22.01.2021, që janë të zbatueshme prej datës së nënshkrimit të tyre.

Neni 90 par. 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L/112 është përcaktuar se “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara më marrëveshjen e tille kolektive*“. Neni 2 par. 1 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është

përcaktuar se: “Dispozitat e Kontratës Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit para universitare (parashkollor, fillore, të mesme të ultë, të mesme të lartë, shkolla speciale dhe qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, [...]”, ndërsa, paragrafi 2 i të njëjtit nen përcakton se: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat – DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in, etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.” Më tej me Nenin 6 par. 4 pika 3 të kontratave të njëjta veç tjerash parashihet se “vend i punës në arsimin e mesëm të lartë është edhe pozita e punëtorit teknik”. Po ashtu me Nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, parashihet se “Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarave u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.1 Mësimdhënës me Shkollë Normale 10% e pagës baze, 1.2 Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19 % e pagës bazë, 1.3 Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçare prej 27 % të pagës bazë, 1.4 Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçare, magjistraturë/master dhe doktoraturë prej 35 % e pagës bazë. 1.5 Përparimet në karrierë, caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje page 10 %.

Në rastin konkret Gjykata gjeti se e paditura në cilësinë e punëdhënësit ka pasur për obligim t’ia paguaj paditëses në cilësinë e të punësuarit kompensimin lidhur me kualifikim/gradim gjatë punës sepse një detyrim i tillë është përcaktuar në dispozitat përkatësisht në Nenin 90 par. 5 të Ligjit të Punës dhe Nenit 7 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë si dhe në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 01/33 të datës 29.08.2008.

Gjykata ka vendosur për lartësinë e kompensimit për licencim për paditësen duke u bazuar në Ekspertizën e ekspertës gjyqësorë financiare A.R sipas se cilës paditëses i takon kompensimi në shumën prej 5,339.76 Euro për periudhën kohore nga data 17.04.2017 deri me datën 21.11.2022 me nga 60.25 Euro për çdo muaj.

Gjykata nuk ia ka fal besimin ekspertizës së ekspertit financiar-aktuaristik A.B sepse i njëjti ka dal jashtë detyrave të përcaktuara nga gjykata duke dhënë mendime ligjore mbi mënyrën e vendosjes.

Nga të cekurat si më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit duke e detyruar të paditurën që paditëses të ia paguaj kompensimin e vendosur si në pikën I të dispozitivit. Dhe meqenëse se i autorizuari i paditëses është tërhequr nga kërkesëpapia për shujta dhe udhëtim ne seancën e mbajtur me datën 27.12.2023 në pajtim me Nenin 261 par. 4 lidhur me par. 2 të LPK-së, gjykata nuk është lëshuar në arsyetim lidhur me këtë çështje.

Gjykata me rastin e vendosjes në këtë çështje ka pasur parasysh kundërshtimet e të paditurës ku ka theksuar se në bazë të Mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës 214//2023 e datës 09.10.2023 ku theksohet se për kërkesat e mësimdhënësit për kompensimin mbi bazën e kualifikimit kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 01/33 të datës 29.08.2008, por gjykata vlerëson se një pretendim i tillë konfirmon se i padituri ka obligimin që paditëses të ia bëjë kompenzimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Mendimi juridik i Gjykatës Supreme thekson se për pagesë të kualifikimit/licencimit për mësimdhënësit kompenzimi duhet të bëhet sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/33 të datës 29.08.2008 në fuqi, sepse Neni 7 i Kontratave Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 nuk ka efekt detyrues.

Gjykata po ashtu ka pasur parasysh kundërshtimet e të paditurës kur ka theksuar se kërkesëpapia e paditësve është e pa bazuar në ligj por nuk i aprovoi sepse në këtë çështje kemi të bëjmë me kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, siç janë kërkesa për kompensimin në emër të kualifikimit/licencimit.

Se e paditura i obligohet paditëses si në dispozitiv të aktgjykimit këtë fakt gjykata e mbështetë në Nenin 245 paragrafi 1 të LMD-së i cili nen parasheh se “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”, ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh se “*Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak*”.

Meqenëse e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e pagave të papaguara për kualifikim/licencim si në pikën 1 të dispozitivit, gjykata konform Nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, si dhe duke u bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, vendosi që e paditura për shumën e detyrimit prej 4097.00 € të paguaj kamatën ligjore prej 8% në vit për periudhën kohore prej datës 17.04.2017 deri me datën 21.11.2022 në shumën prej 1,242.76 €.

Vendimin lidhur me shpenzimet gjykata e ka bazuar në Nenin 452.1 dhe 453 të LPK-së, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditëses të ia paguaj shumën prej 200 Euro për ekspertizën financiare të ekspertes A.R të datës 15.12.2023 shumën prej 200 Euro për ekspertizën e ekspertit A.B të datës 13.09.2021 dhe shumën prej 50 Euro për plotësim të ekspertizës të datës 06.12.2021 të ekspertit financiar A.B, shumën prej 104 € për padi, 20 € për taksë gjyqësore dhe për 5 seanca të mbajtura gjyqësore në shumën prej 810 € sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, në shumën e përgjithshme prej 1.334,00 Euro.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC-
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil, C. nr. 219/2020 datë 26.01.2024**

**Gjyqtari
Astrit Gashi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditë, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.